

NERTILA ZANI

PËRDORIMI I IRONISË NË LIGJËRIMIN GAZETARESK

“*Ironia*” - fjala ironi vjen nga greqishtja eironeia - tallje e fshehur, shtirje. Është tallje e hollë dhe e fshehur me intonacion lavdërues, që nënkupton të kundërtën, ndërsa përdorimi i fjalës është me kuptimin e antonimit të saj.

Shembull: Falë zotave, fatkeqësia ime ia kalon shpresës...

Ndryshe nga ironia e shkruar, ironia e folur është një formë e shprehjes joletrare, që nënkupton një thënie, e cila ndryshon nga ajo çka thuhet me atë që kërkon të transmetojë ose të nënkuptojë. Ironia mund të prodhohet në mënyra të ndryshme dhe shumë prej tyre korrespondojnë edhe me figurat e retorikës klasike, siç mund të jenë antifraza ironike, hiperbola ironike, lilita ironike, etj.

Përcaktimet e ironisë shkojnë duke u nisur nga një pikë e ngushtë drejt një rrethi më të gjerë (Mercier – Leca, 2003)¹. Duke u nisur nga pika më e ngushtë e asaj që mendojmë (anifraza ironike), drejt një rrethi më të gjerë, ku kemi të bëjmë me një diskurs ironik, një diskurs me anë të të cilit do të kuptonim tjetër gjë nga ajo çka është thënë me fjalë.

Duhet të pranojmë se ironia është pjesë e përditshme e së folurës dhe jo vetëm në shtyp, media, por edhe në jetën shoqërore. Çdokush përdor ironi kundrejt një të njohuri, qoftë për t'i dhënë vlera negative, qoftë për t'i dhënë vlera pozitive. Me ironi do të kuptonim vënien në lojë të dikujt me anë të fjalëve.

Philip Hamon (1996: 4) thotë se ironinë e gjejmë nga pak kudo, në biseda, në portrete dhe kjo, sidomos, në gazetatat satirike, ku ironia zë hapësirën kryesore, duke iu drejtuar personazheve të njohur por, mbi të gjitha, ligjërimeve që ata mbajnë herë pas here.

Për ironinë është shkruar qysh nga grekët me Aristotelin, më vonë nga Ciceroni dhe Quintilien, e deri në ditët e sotme, ku vazhdojnë të trajtohen dhe studiohen përdorimet ironike.

Le të shohim disa përkufizime të ndryshme mbi ironinë.

Ironia është një figurë prej së cilës kërkojmë të kuptohet e kundërta e asaj që themi: kështu që fjalët që shërbejnë për të ndërtuar ironinë nuk janë marrë në kuptimin e tyre të parë (Dumarsais: 1967:199).

Edhe në rastin e gazetarëve të shtypit të shkruar, e përdorin ironinë për të treguar një realitet ndryshe nga ajo që na shfaqet shpesh herë në mediat televizive dhe fasada të ndryshme.

Ndërsa në Fjalorin e Retorikës, Georges Molini (1992: 180) e përkufizon ironinë si më poshtë:

¹ F. Mercier-Leca (2003). *L'ironie*. Paris: Hachette Supérieur.

“Ironia është një figurë e tipit makrostrukturale që luan mbi karakteristikat intensive të thënies: si e thotë dikush, ne themi të kundërtën e asaj që duam të kuptojmë. E rëndësishme është të shohim mirë karakterin makrostruktural të ironisë: një diskurs ironik zhvillohet në një shumësi thëniesh përmes së cilave është e vështirë të izolosh, qoftë edhe formalisht termat specifike që mbartin ironinë, por në rastin e antifrazës² kjo gjë është e mundur, nga ana tjetër është i gjithë qerthulli i pasazhit të interpretimit të ironisë, e cila nuk mund të jetë gjithmonë e kapshme”.

Për të shprehur ironinë gazetarëve iu duhet të jenë në qendër të informacioneve, duke njohur shumë mirë thelbin e situatës me anë të së cilës duan të ironizojnë. Pa njohur deri në thellësi situatën, ironia që synojnë mund t’iu kthehet në ironi për vetveten.

Ironinë e përdorur në titujt e gazetave e gjejmë në një fjalë të vetme, ose edhe në përmbajtjen e gjithë titullit.

Në ironinë e folur kemi të pranishëm një thënës dhe një thëniemarrës. Kur flasim për ironinë e folur, jo domosdoshmërisht kemi vetëm dy pjesëmarrës në bisedë. Këtë e gjejmë edhe në bisedat televizive, ku janë më shumë se dy të ftuar, në parlament ku numri që përfshihet në ironi është më i madh. Ironia në biseda mund të jetë spontane, por jo gjithmonë.

Për të përshkruar strukturën e frazës apo tekstit të ironisë që do të analizojmë, duhet të ndalemi në tri pikat kryesore. E para, duhet ta shohim në një kontekst thënëzimi, pastaj nga pikëpamja e thënësit ironik dhe e fundit duhet ta shohim nga thëniemarrësi. Te thëniemarrësi dekodimi i thënies varet jo vetëm nga aftësia e tij për të kuptuar atë çka thuhet, por të kuptojë atë çka thënësi ka si qëllim të transmetojë.

Duke qenë se pjesa më e madhe e gazetave në vendin tonë janë të ndara nga pozicionet politike, pra në të majta dhe të djathta, edhe përdorimin e ironisë e kanë të drejtuar kundrejt referentëve të caktuar. Një gazetë e majtë do të ironizojë politikanët e djathtë, një gazetë e djathtë do të ironizojë politikanët e majtë.

➤ P.sh.: *Rama shpall veten Super – bashkiak.*

Për të kuptuar këtë thënie lind nevoja për marrjen e informacionit të plotë se për çfarë bëhet fjalë. Nuk ka shumë kohë që kanë kaluar zgjedhjet vendore të 2015-tës dhe kryeministri i Shqipërisë ka ftuar të gjithë kryetarët e zgjedhur të të gjitha njësive vendore në një takim të përbashkët, ku shumë nga kryetarët e zgjedhur të koalicionit të djathtë kanë munguar. I gjithë fjalimi i tij nuk të çon aspak në këtë ironi të përdorur nga thënësi.

Ironinë në këtë frazë e gjejmë te fjala *super – bashkiak*.

Në këtë rast dimensionin e ironisë perceptohet me zmadhimin e identifikueshëm brenda një procesi që rezulton në subjektivizëm. Diskursi sistemohet në raport me konstruktivitetin dhe me destruktivitetin dhe ironia

² Sipas Molinie (1992:57) antifraza është një trop, sipas së cilës të shprehurit e thënies kuptohet me të kundërtën e kuptimit të saj të vërtetë, për të përcaktuar mohimin ose të kundërtën.

Përdorimi i ironisë në ligjërimin gazetaresk

gjuhësore e kalon këtë hipotezë të vënë në lojë. Megjithatë, ironia dhe ironizimi nuk kanë përmasat e konfliktit. Domethënia politike e diskursit përfaqësohet përmes konceptit të individualitetit, të etosit të politikanit. Të shenjuarit e egos shndërrohet në retorikë figurative dhe bëhet super ego. Kjo mund të jetë referencë e një kapërcimi nga **status quo** drejtë një filozofie të re të të menduarit dhe të vepruarit. Këtu ironia karakterizohet përmes supozimit, deri te groteskja.

Vetë thënia ironike mund të përshkruhet semiotikisht me anë të termit/konceptit çmbrehës, në dy operacionet thënëzuese: atë të mbrehjes dhe çmbrehjes.³

Në këtë thënie thënësi projektton një jo – unë, që do të kuptonim një ai, por kemi të nënkuptuar një mbrehës kohor, sepse dihet kur është mbajtur takimi i Edi Ramës me kryetarët e bashkive, gjithashtu thënësi di edhe vendin ku është mbajtur takimi. Në një thënie të vetme kemi të pranishëm një çmbrehës subjekti dhe dy mbrehës, atë kohor dhe vendor, duke ditur kohën dhe vendin e referentit.

Një situatë thënëzuese, ndryshe nga çfarë thamë, konsiston në atë që thënësi projektton një unë ose një ne (mbrehës aktant), një këtu (mbrehës vendor) dhe një tani (mbrehës kohor) dhe ironia në thënie bëhet më domethënëse.

Në ironi i kemi të përfshira të dyja këto operacione, sipas rasteve që na paraqiten.

➤ P.sh.: *'Magjistari' turk 'Kurum', me 1.2 milionë tonë skrap ka prodhuar 1.5 milionë tonë hekur në vit! Blerje ilegale e 2 anijeve të huaja për skrap dhe shpërfillja e shtetit.*

Duke dashur të nxjerrë në pah një anomali që ka ndodhur me kompaninë Kurum dhe se si kjo kompani vepron jashtë ligjeve, ironizuesi (gazetari) e quan magjistari, sepse vetëm një magjistari mund të bëjë shumëfishime me numrat e tij të shpejtësisë. Pra, nga 1.2 milionë e bën 1.5 milionë. Për të kuptuar ironinë që përcillet duhet që lexuesi i kësaj gazete, të ketë një informacion rreth kësaj kompanie që vepron në Elbasan prej vitesh.

Në këta paragrafë përdorimi dhe funksioni i ironisë mbështetet në misteret e një veprimi, ndërkohë, thelbi i argumentimit e prodhon efektin psikologjik të situatës së sajuar nga logjika e efektit diskursiv. Hiperbolizimi i informacionit na çon drejtë dyshimit mbi të vërtetën.

Në një proces thënëzimi ironik, herë pas here, del e nevojshme të jetë i përfshirë edhe një i tretë, një ai. Kjo ndodh kur i drejtohem një të treti, i cili nuk është prezent. Në rastin e bashkëbisedimit, në dialog, ironia mund të jetë për personin prezent, por mund të ironizojmë edhe me një të tretë që nuk është prezent në vendin dhe kohën kur kumtohet thënia. Në rastin e thënieve ironike që kemi

³ Kur i referohemi termave nga frëngjishtja *embrayeur/emrabyage* dhe *debrayage* dhe *debrayeur*, këto fjalë mungojnë në fjalorë të gjuhës shqipe, sajohet nga folja mbreh, nga e cila sajohet edhe fjalë mbrehje për *embrayage*, kurse folja çmbreh janë përfutur dy skaje gjuhësore çmbrehje dhe çmbrehës për skajet gjegjëse *debrayage* dhe *debrayeur*. (R. Pernaska, T. Plangarica, Mbi disa skaje filozofike – logjike-gjuhësore në fushën e sintaksës së shqipes, teorisë së të thënit/pragmatikës dhe gjuhësisë tekstore)

marrë për të analizuar, i treti, apo personi që vihet në lojë, nuk është prezent; e para sepse kemi të bëjmë me një thënie të shkruar dhe e dyta, në diskursin gazetaresk, gjithmonë i treti nuk është prezent, përveç bisedave televizive.

Thënësi ironizues nuk i drejtohet me një **ti/ju** thëniemarrësit, por i drejtohet me një **ai**. Në një thënie ironizuese kurrësi nuk mund të gjejmë një **unë**, por kemi gjithmonë një të tretë me të cilin ironizojmë.

Një tjetër shënjes për të treguar ironinë në të shkruar është edhe pikëçuditja në fund të thënies. Shpesh herë pikëçuditja shënjon vlerën e kundërt të asaj që është thënë.

➤ P.sh.: *Ka humbur trageti Pogradec – Ohër.*

Pas një marrëveshjeje për të vendosur një linjë trageti Pogradec – Ohër, qysh para 7 viteve, nga të dyja palët e qeverive përkatëse, ende trageti nuk funksionon. Para një viti është bërë edhe një pritje zyrtare e tragecit, i cili më pas ka ardhur edhe disa herë dhe nuk funksionoi më si linjë transporti. Nëntitulli i gazetës e ironizon bukur mosfunksionimin e kësaj linje transporti dhe, në mes të kësaj ironie, etiketohet ministri aktual i transporteve.

Në nivelin e artikullimit të ndodhisë, justifikimi i ironisë së drejtpërdrejtë shndërrohet në ironi kontekstuale. Etiketa synon të bëhet shfaqje e një veprimi, ndërsa ironizimi prodhim i një iluzionit retrospektiv [Zh. Zhenet]

Për të kuptuar ironinë që kumtohet duhet që lexuesi të ketë njohuri jashtë gjuhësore mbi këtë fakt. Nëse një lexues i këtij kryetitulli, nuk e di që ka pasur një marrëveshje, dhe kjo e fundit është zbatuar vetëm dy a tri herë, menjëherë do të reagojë dhe do të pyesë se kur paska pasur linjë trageti Pogradec – Ohër. Pra, njohja e kontekstit nga ana e lexuesit, për të cilën ironizohet në thënie, e bën këtë thënie edhe më ironizuese.

➤ P.sh.: *Picierët zëvendësojnë postierët. Zhduken në drejtim të paditur 63.5 milionë USD dhe Shqipëria nuk ka një adresar të saktë. 30% të letrave në magazinat e Postës dhe shërbimi i vetëm është ai i picierëve.*

Ironia e përdorur duke krahasuar një picier me një postier, na nxjerr në pah jo vetëm faktin që postieri nuk njeh mirë adresat, por edhe që investimet e bëra kanë shkuar në drejtim të paditur.

Aktantët, picierët dhe postierët, përbrenda diskursit ironik e ironizues, marrin atribut shenjzuese për të treguar prezencën e anomalive që ndodhin në shoqërinë tonë. Ironia këtu është konvencion, i cili i ndërlidh dy skajet e formulimit të supozimit, brenda intertekstualitetit të vet. Supozohet që picierët kanë zëvendësuar postierët. Në realitet nuk është supozim, sepse e dimë që postieri nuk ka asnjë lidhje me picierin.

Rrjedhimisht, aktantët, picierët dhe postierët, mbesin emërtime të një kodi dhe ironia i tejkalon sinorët, duke shkuar drejt groteskes.

➤ P.sh.: *Hetim ‘Sulltanit’ të 16 mijë infermierëve.*

Në këtë thënie bëhet fjalë për kreun e infermierëve që mbledh kuotizacionin për çdo infermier. Gazetari ironizon kreun Sabri Skënderin, duke e quajtur sulltan, sepse u sekuestron çdo punonjësi të mjekësisë nga 12 mijë lekë, shumë e cila, në fund të vitit, shkon në 200 milionë. Këtu ironia është burim i një hulumtimi në

proces. Funksioni i saj modelohet midis faktit, realitetit, diskursit dhe domethënies. Ironia ndërtohet mbi një fjalë të vetme ‘Sulltanit’ dhe tregon një realitet të nënkuptuar korruptiv. Fillon me një supozim dhe shkon drejt krijimit të një miti siç është Sulltani.

Argumenti, në këtë rast, do ta përqafonte referencialitetin në këtë këndvështrim, duke u nisur nga ironia drejt satirës, sarkazmës dhe anasjelltas.

Teoritë pragmatike mbi përdorimin e ironisë këmbëngulin mbi faktin që ironia mbështetet mbi një të kundërt pragmatike që ekziston midis të thënit në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe njohurive të kontekstit.⁴ Para se të bëjmë një analizë pragmalinguistike duhet të marrim në konsideratë tri konceptet themelore të pragmatikës sipas Armengaud: që janë koncepti i aktit, koncepti i kontekstit dhe koncepti i performancës.

Me konceptin e parë thënësi ose ironizuesi, me anë të gjuhës, nuk bën vetëm një përfaqësim të botës me fjalë, por vepron mbi tjetrin. Gjithashtu merr parasysh kontekstin ku vepron, vendin, kohën dhe identitetin e të tretëve. Me konceptin e performancës do të kuptohet një ndërveprim i aktit me kontekstin, pra nuk do të merret parasysh vetëm akti, por edhe konteksti thënëzues ku vepron ky akt.

➤ P.sh.: *Ditën gjumë, natën tym.*

Bëhet fjalë për kompaninë Kurum, e cila vepron në qytetin e Elbasanit prej 23 viteve, mirëpo nga data 10 prill 2015 është bllokuar aktiviteti i kompanisë turke, ndërsa kjo vazhdon prodhimin, duke paguar bosët e pushtetit. ‘Kurum’, ditën ‘GJUMË’ i bllokuar nga shteti, natën punon me bekimin e shtetit.

Kjo mund të jetë një lloj ironie antitetike⁵, e cila e shpjegon ballafaqimin midis dy gjendjeve apo situatave. Karakterizimi përshkruet e gjen hapësirën e diskursit drejt karakterizimit problematizues. Perceptimi orientohet te vepruesi, për të sajuar rrëfimin nga shmangia e zhvendosjes së imazheve pararendëse.

Thënësi ironizues, në momentin që ironizon, merr në konsideratë dy struktura të kundërta me njëra tjetrën, që janë e thëna dhe e besueshmja. Pra, thënësi thotë diçka, por lë të besohet diçka tjetër. Me të thënë të do të kuptonim ligjërimin e shkruar apo të folur. Ndërsa të besuarit apo të kuptuarit kuptojmë dekodimin nga thëniemarrësi.

Nëse do i referohemi fjalorit të Oxfordit, ironia është një strukturë e çështjeve, ose është një ngjarje që duket se qëllimisht është në kundërshtim me atë që e pret dhe e shpreh, duke qenë edhe zbavitëse, ashtu siç e ka edhe rezultatin.⁶

➤ P.sh.: *Arresti i 20 – vjeçarit ‘E priti policinë me duart në xhepa’*

Bëhet fjalë për vrasësin e dy turistëve çekë, i cili u kap në shtëpinë e një zonje.

Në këtë shembull, diskursi, kriterin bazë e ka te grotesku dhe ironizimi i gjendjes.

⁴ Cf. M. Nekula, *Pragmalinguistická interpretace ironie*, Slovo a slovesnost, n° 51, 1990, pp. 95–110.

⁵ Kundërvënja e dy koncepteve apo dy mendimeve për t’i dhënë forcë shprehjes.

⁶ *New Oxford English Dictionary*.

Ironia e shkruar ngelet gjithmonë në përmasat virtuale, sepse është lexuesi që do ta dekodojë mesazhin që gazetari lë të besohet. Por, lexuesi, thëniemarrësi, nuk ndan të njëjtin sistem idesh, besimesh, doktrinash, ideologjish me thënësin dhe dekodimi mund të mos jetë në përmasa të njëjta nga njëri marrës te tjetri, ose mund të mos besohet ajo çfarë ka pasur si qëllim thënësi.

Ironinë duhet ta shohim, përveçse nga pikëpamja e thënësit dhe thëniemarrësit, edhe në dimensionin njohës, se ç'është ironia dhe në çfarë përmasash përdoret ajo. Në një thënie ironike, përveçse mesazhit të kundërt që përcillet, brenda saj gjejmë edhe kritikë, edhe tallje, edhe shtirje apo ligësi. Në thëniet e mësipërme, gjejmë edhe kritikë edhe tallje.

BIBLIOGRAFI

- C. C. Dumarsais. 1981: *Traité des tropes*. Paris: Le Nouveau Commerce.
- C. Kerbrat –Orecchioni 1976: *Problèmes de l'ironie*. In: *Linguistique et Sémiologie 2: L'ironie*. p. 9-45, Lyon: Travaux du Centre de Recherches Linguistiques et Sémiologiques de Lyon.
- C. Kerbrat-Orecchioni. 1980: *L'ironie comme trope*. In: *Poétique 41*: 108-127. Paris: Seuil.
- Dictionnaire de Rhétorique*, Georges Molinie. Publisher French & European Publications, Incorporated, 1992.
- Dumarsais-Fontanier. 1967: *Les tropes*. Tome I. Genève: Slatkine Reprints.
- Dumarsais-Fontanier. 1967: *Les tropes*. Tome I. Genève: Slatkine Reprints.
- F. Mercier-Leca, *L'ironie*. Paris: Hachette Supérieur (2003).
- G. Molinie. 1992: *Dictionnaire de rhétorique*. Le Livre de Poche. Paris: Librairie Générale Française.
- K. Cogard, *Introduction à la stylistique*, Champs Université Flammarion 2001.
- M. Nekula, *Pragmalingvistická interpretace ironie*, Slovo a slovesnost, n° 51, 1990.
- New Oxford English Dictionary*.
- P. Fontanier. 1977: *Les figures du discours*. Introduction par Gérard Genette. Paris: Flammarion.
- P. Hamon, *L'ironie littéraire: essai sur les formes de l'écriture oblique*, Hachette supérieur, 1996.
- Gazeta 55, 7 korrik 2015, Gazeta Telegraf, 2 korrik 2015.
- Gazeta Telegraf, 29 qershor 2015, Gazeta Telegraf, 17 qershor 2015.
- Gazeta Telegraf, 4 korrik 2015, Gazeta Telegraf, 1 korrik 2015.